

Njoftim

për plotësimin e formularit për në Institucionet e Arsimit të Lartë

Njoftojmë të gjithë maurantët/kandidatët që dëshirojnë të marrin pjesë në garën e pranimit në IAL nëpërmjet përzgjedhjes së programeve të studimit preferenciale midis atyre të ofruara për vitin akademik 2017 – 2018 nga Institucionet Publike dhe Private të Arsimit të Lartë, se mbështetur në VKM nr. 346 datë 19.04.2017, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2017-2018”, duke filluar nga ***dita e premte dt. 19.07.2017***, ata duhet të ndjekin procedurat e mëposhtme:

Së pari duhet të shkarkojnë nga faqja e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP) sot Qendra e Shërbimeve Arsimore www.akp.gov.al faturën për arkëtim tek linku **fatura për arkëtim për plotësimin e formularit për në IAL**, dhe më pas ta printojnë.

Me këtë faturë të printuar duhet të paraqiten pranë secilit filial të bankave të nivelit të dytë për të kryer pagesën e tarifës përkatëse prej 2000 lekësh.

Më pas të paraqiten në drejtorinë e shkollës, në të cilën kanë bërë aplikimin e formularit A1, apo A1Z dhe dorëzojnë mandat pagesën.

Pas dorëzimit të mandat pagesës, punonjësi i autorizuar nga drejtoria e shkollës hedh në sistemin informatik notën mesatare të tij e llogaritur sipas VKM nr. 346 datë 19.04.2017.

Vëmë në dukje se maurantët që nuk ndjekin procedurën e mësipërme nuk kanë mundësi të aplikojnë me formularin e aplikimit për në IAL për shkak të mungesës në sistem të notës mesatare.

Përzgjedhja e programeve të studimit preferenciale (<= 10) ndërmjet atyre që ofrohen nga IAL-të publike dhe private do të bëhet në portalin e Maturës Shtetërore Online në adresën matura.akp.gov.al

Afati i plotësimit të notave mesatare në sistem është nga data 19.07.2017 ora 08.30 deri 28.07.2017, ora 16.30.

Gjithashtu aplikantët për në IAL duhet t’i përshtaten kalendarit të aplikimeve të publikuar në faqen tonë. Psh maurantët dhe kandidatët e Dar Tiranë kanë afat të plotësojnë mesataren deri në datën 22 korrik 2017, meqënëse kjo është edhe data e fundit e aplikimit për maurantët e këtij Dar-i. Po njësoj për secilin Dar/Za afati i fundit i plotësimit të mesatareve në sistem është ai kur kanë ditën e fundit të aplikimit.

Suksese !

Qendra e Shërbimeve Arsimore